

PRESTIGE



PËRSHKRIMI

Stuko me bazë çimento, me granulometri të seleksionuar dhe me një qëndrueshmëri të lartë ndaj ujit

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Është material në formë pluhuri me bazë çimento, me pluhur guri natyral me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike, aditivë hidrofobikë dhe pigmente ngjyres.
- Punueshmëri dhe hapje mjaft e mirë.
- Pastrohet lehtësisht.
- Në përfundim jep një sipërfaqe të lëmuar.
- I papërshtueshëm nga uji.
- Rezistencë të lartë kundrejt bazave (alkaleve) dhe detergjentëve.
- Rezistente ndaj gërryerjes (korrozionit)
- Rezistente ndaj rrezatimit UV.
- Parandalon procesin e floreshencës.
- Sipas klasifikimit të EN 13888 i përket kategorisë CG2-WA.

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

PRESTIGE përdoret për stukimin e fugave me hapësirë 0 - 5 mm midis pllakave prej qeramike poroze, monocotto, bicotto, gres, porcelan dhe gur natyral. Për stukimin e dyshemeve dhe veshjeve të jashtme, kur kërkohet një rritje e papërshkrueshmërisë, elasticitetit dhe forcës mekanike, për sipërfaqe me vibrim, për sipërfaqe me bymim dhe tkurje (tarraca, dysheme me ngrohje, pishina, shatërvane, etj), produkti duhet të përforcohet me 500 gr aditiv të holluar në 700 - 1000 ml ujë për një qese PRESTIGE prej 5 Kg.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	30 ngjyra, sipas katalogut të produktit
Granulometria maksimale:	0,2 mm
Sasia e ujit për hidratim:	1.5 l/5 kg
Temperatura e aplikimit:	nga +5°C deri në +35°C
Dimensioni i fugave:	deri në 5 mm
Rezistenca në ngjeshje:	
• Në kushte normale:	32 Mpa
• Pas cikleve ngrirje shkrire:	29 MPa
Rezistenca në përkulje:	
• Ne kushte normale:	5,5 MPa
• Pas cikleve ngrirje shkrire:	5,2 MPa
Rezistenca ndaj gërryerjes:	725 mm3
Ujëthithja pas 30 min:	1,3 Gr
Ujëthithja pas 240 min:	3,4 Gr
Tkurja:	0,9 mm / m
Rezistenca temperatore:	nga -30°C deri në +90°C

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përzieri pluhurin me ujë të pastër në një raport 1lt / 5 kg. Shtoni ADMIX S2 drejtpërdrejt në përzierje dhe miksoni me një mikser elektrik me revolucion të ulët, derisa të merrni një përzierje homogjene. Pushoni përzierjen për 10 minuta dhe trazojeni përsëri përpara aplikimit.

APLIKIMI

Hapësirat midis pllakave mbushen lehtësisht duke përdorur një mallë prej gome. Heqja e masës së mbetur duhet të bëhet me një sfungjer të lagësht në momentin kur PRESTIGE të ketë arritur qëndrueshmërinë, konsistencën e kërkuar (konsistencë kjo që arrihet për rreth 20 minuta mbas aplikimit të PRESTIGE). Pastrimi përfundimtar i pllakave bëhet me një copë të thatë. Pastrimi përfundimtar mund të bëhet edhe mbas një dite kur materiali është forcuar, në këtë rast zgjidhet një copë e përshtashme për pastrim.

PAKETIMI

Kova plastike 2Kg / 5Kg

RUAJTJA

24 muaj nëse ruhet në paketimin e vet origjinal të pahapur.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

